VENDIM
Nr. 222, datë 9.4.2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 837, DATË 28.10.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE RREGULLAT PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË PUNËSIMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 7, të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit", me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kreun II, të vendimit nr. 837, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për ofrimin e shërbimeve të punësimit", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pikat 1 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"1. Struktura vendore e punësimit, pas kërkesës për regjistrim të punëkërkuesit nëpërmjet shërbimit në portalin "*e-Albania*", duhet të sigurojë informacion lidhur me statusin social, përkatësinë sipas grupeve të veçanta, historikun e punësimit, si dhe të dhëna të tjera plotësuese, nëse është e nevojshme, nëpërmjet ndërveprimit me baza të tjera të dhënash shtetërore.".

...

"4. Nëpunësi i strukturës vendore të punësimit ofron shërbimet dhe programet përkatëse për punëkërkuesin e papunë, duke ndjekur qëllimet, aktivitetet dhe afatet e përcaktuara në planin individual të punësimit.

Afati i zbatimit të planit individual të punësimit për punëkërkuesit e papunë, që përfitojnë nga skema e garancisë rinore, nuk duhet të jetë më shumë se 4 muaj, ndërsa për të gjithë punëkërkuesit e tjerë plani mund të jetë deri në 12 muaj.

Për zbatimin e planit individual të punësimit, struktura rajonale dhe vendore e punësimit bashkëpunon me të gjitha institucionet dhe aktorët e tjerë publikë apo privatë të specializuar për trajtimin e problemeve dhe të pengesave sociale apo shëndetësore të punëkërkuesit të papunë.".

b) Në nënndarjen "ii", të shkronjës "ç", të pikës 5, pas fjalëve "... këtij plani" shtohen "... brenda një muaji ...".

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku